

INTERVISTË ME IBADETE BUNJAKU - AHMETAJ

Prishtinë | Data: 12 maj, 2017

Kohëzgjatja: 70 minuta

Të pranishëm:

1. Ibadete Bunjaku - Ahmetaj (E intervistuar)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Zonja Ibadete, a mundesh me na fol.... Ma s'pari prezantohu para kamerës dhe mandej me na fol për fëmëninë tonde t'hershme edhe kujtimet e tua t'para.

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po. Unë quhem Ibadete Bunjaku, tani Ahmetaj. Jam lind në Prishtinë, jam rritë. Jam rritë në rrugën Svetozar Markoviq, ish rruga Svetozar Markoviq, afër shkollës ish-“Milladin Popoviq”, tani “Pjetër Bogdani”. Aty e kom kry tetë-vjeçaren. Pastaj dy vite i kom kry në shkollën teknike dhe dy vitet e fundit, viti tretë dhe katërt, i kam kry në Shkollën Normale, drejtimi sekretare e programit të redaksisë.

Fëmijëria e hershme osht' interesante se unë rrjedh prej një familje ish të burgosur politik. Domethanë, qysh si fëmijë jemi frymëzu me ide patriotike. Shpesh herë m'kujtohet vllau im i madhi, Xhaviti, që udhëtojke larg e larg, për me inçizu filma të Shqiprisë edhe me i shiku ne, edhe me u eduku në qat' frymë. Kemi qenë nxansa t'mirë, por edhe lagjen ku kom jetu une kemi pasë shumë, shumë, shumë, shumë njerz t'mirë. Domethonë, kemi pasë fat që jemi rritë me një lagje jashtëzakonisht të mirë, të qetë, që të gjithë intelektual, pasi edhe ne ishmi, ishim prej një familje intelektuale.

Kështu që, ne u rritëm duke mësuar vjersha, duke ndëgju lloj-lloj storje interesante që nga babai... duke tregu babai luftën e Kitkës, që është një luftë jashtëzakonisht e rëndësishme... duke tregu se si ka qenë në atë kohë ballist, si kanë luftu, e kështu me radhë. Unë gjithmonë kisha kureshtjen, noshta isha shumë kureshtare se isha edhe fmiu më i vogël n'shpi, tanë kohën t'u i bo presion babit tim të m'tregon se çka është lufta, çka ka ndodhë atëhere, gjithshka... sa, sa jonë shkollu vajzat, e kështu me radhë. Se dëgjojsa zakonisht storjet që femnat shumë pak kanë pasë të drejta në atë kohë, mos t'them fare hiç. E kështu që, babi im ka qenë shumë interesant. Ai na ka dhonë motiv edhe vullnet që ne të msojmë, të kryjmë fakultete dhe të bëhemi zojat e vetës.

Erëmirë Krasniqi: Çka tregojke për atë kohë babi?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Zakonisht na tregojke luftat e Kitkës, qysh kanë ndodhë n'atë kohë.

Erëmirë Krasniqi: N'cilën zonë osht'?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Zona e Hogoshtit, përmi Hogosht osht'. Viti tash nuk m'kujtohen krejt, mirëpo na tregojke se si plakat e vjetra, burrërore, si i kanë qujtë n'atë kohë, kanë ba sene shumë interesant, edhe shumë se si i kanë mshef, domethanë i kanë, nuk i kanë tregu gjermanve ose italianve n'atë kohë që kanë qenë aty... edhe kështu me rradhë. Zona ilegale kanë qenë ato pjesë. Edhe i ka pasë baba im disa sheja n'kokë, edhe gjithmonë thojsha, "O bab ça ki kshtu?" "Eh, këto janë gjitha shenjat e luftës që kam qenë, por dashti fati që unë të pshtoj."

E kisha, e shijsha unë edhe kështu n'familje që baba im asniherë nuk i bojke presion nanës time, a din, të thotë, "Ej, ti je grua, ti duhesh me bo kta, ti duhesh me bo kta..." por gjithmonë i ka thonë nanës time, "Ti je gru, po s'ka lidhje, ti duhesh me punu me fmi, e sidomos me vajzat." Shpesh herë nana ime xhelozojke nganiherë pse mu babi m'lije pare ndër jastëk... "Shko blej këto libra, këto libra, dhe lexoj se janë shumë për t'mirën tane." E kështu me radhë. Edhe fillunë vitet, jo '81, po fillunë vitet ma herët se '80-shja...

Erëmirë Krasniqi: Kur keni lindë ju?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Kom lindë në vitin 1969.... Edhe e shihsha që u mblidheshin shumë burra aty, besa edhe disa gra në familjen time, po, n'shtëpinë time, edhe bisedojshin. Por ne ishmi fmi, isha dikun n'klasën e pestë. Por interesant, kurreshtja edhe gjatë leximit kuptojshmi diçka. Edhe gjithmonë i thojshmi edhe vllaut tem, "Diçka po ndodhë," a din, "po ju s'po na tregoni." "Vjen koha që do t'i kuptoni."

Edhe m'kujtohet sikur sot viti '81. Isha n'klasën e gjashtë. Shumë mirë e kujtoj atë ditë. I lishum gjithë ortë e msimit, se ndodhën demonstratat. Edhe ishte ora dikun gjashtë e mramjes. Une me vajzën e axhës time... se jetoj, jetojshmi me ni oborr, "Ku po shkojmë?" "Hajde po shkojmë," tha, "n'qendër." Une afër e kisha te shkolla teknike shtëpinë. Po shkojmë të Shtëpia e Mallrave përpara ku ka qenë. Çka me ardhë këtu me pa? Interesant. Plot studenta, plot. Edhe po na japin neve do bukë me jau shkep studentave. Dhe shumë interesant ai vullneti i tyne, jo-frika, po...

Erëmirë Krasniqi: N'qendër, n'rrugë, a qysh?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: N'rrugë, m'rrugë, këtu n'sheshin "Nëna Terezë" që osht' tani. Kish, ish mbulu prej studentave. Edhe disa njerz veç po na japin neve bukën, "Shkoni edhe jepjani studentave se jonë pa hangër tanë ditën." Edhe u bo mramja, ra terri, edhe vajza axhës met midis studentave. Qysh klasa gjashtë... edhe unë po filloj me qajtë, edhe shumë shpejtë ka ardhë vllau jem, nuk di si m'ka pa.... Veç fillunë gazet lotsjellse. Ai e kishte marrë ni femën edhe po e marrke zvarrë se ishte alivanosë.

"Ça ke lyp ti këtu?" "Po," thashë, "ku jeni ju edhe na." A din, tanë kohën na krejt fshehurazi t'u shku për mos me na pa. Edhe u sigurum me çikën e axhës, dul disi. Pastaj, mixha jem vrap na ka kap për dore

edhe na ka çu n'shpi. Edhe kështu që, gjithmonë jemi motivu prej atyhit. Po, osht' interesant, unë edhe si fmi, kam qenë shumë i gjallë [si] fmi. Edhe n'lagjen ku kam jetu une ka pasë edhe disa turqi edhe si fmi kemi pasë pak konflikte, po jo konflikte t'mdhaja që mos me mujt me u marrë vesh. Na aty noshta u kacafytshmi kapak, ata m'thojshin, "Sulltan Murati", unë thojsha "Skënderbeu". Si fmijë, a po kupton? Jonë disa storje... që unë tash kom shumë raporte t'mira me ato tani, me ato t'lagjes time. Edhe shpesh herë m'thotë ajo shoqja, "Ej a din qysh m'thojshe ti Skenderbeu juve ju ka ardhë hakësh?" E kështu me radhë.

Pastaj, viti, viti parë, shkolla e mesme teknike. Fillunë t'i burgosin familjartë e mi.

Erëmirë Krasniqi: Për çfarë arsye? A kanë qenë ma herët t'burgosun apo ishte hera e parë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Isha hera e parë që u burgosën. Osht', i pari osht' burgosë Ramadan Bunjaku. Osht' burgosë me grupin e Naim Shalës. Mas dy viteve.... Po në atë kohë kur osht' burgosë Ramadani, i kanë marrë n'biseda informative që të gjithë burrat e shpisë, edhe kanë nejtë, domethonë, tanë ditën, deri t'nesrit në mëngjes kur kanë ardhë... as vet s'di sa kampanjola t'policijës. Neve na kanë futë me një qosh. Edhe t'u na fy, fyrjet ma t'randa ku kanë qenë, "Ju nuk dini kurgjo, ça jonë këto libra?" Zunën libra të Kadaresë, libra që nuk u lejojshin n'atë kohë, po ne i siguronim disi edhe i lexonim që të gjithë familjarët, prej ma t'voglit e deri ma t'mdhajt. E pastaj gjithmonë i raportoishmi mes veti çka nuk kemi kuptu, dhe çka kemi kuptu dhe çka po i përshtatet situatës që jemi tani.

Erëmirë Krasniqi: Cili vit ish ky?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Viti '83. Mbetën që të gjitha gratë pa burra në shpi. Ka qenë jashtëzakonisht ni situatë e ranë n'atë kohë. Edhe prej asaj dite une kom vendosë me u marrë me llegalën.

Erëmirë Krasniqi: A po m'tregon ma, ma detajisht për çfarë, çfare ke arsyetimi kur i murrën ata n'burg? Çfarë preteksti?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Arsyetimi i burgosjes, preteksti ka qenë nacionalizëm, irredentizëm. Ramadani ka qenë student jashtëzakonisht i mirë i vitit të katërt, domethonë, n'përfundim të Fakultetit Juridik. S'di sa provime i ka pasë që... e mbyllën. U dënu me dhetë vite burg në sezejën e Beogradit për irredentizëm, nacionalizëm, e këso.

Erëmirë Krasniqi: A ishte ai axha ju?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Djali axhës, po, se axha im ishte shumë i vjetër. Gjithashtu edhe babi im ka qenë, se unë jom fmia ma i vogël. Mas dy viteve u dënu Nuhi Bunjaku me grupën e Kafexhollit, Rifat

Kafexhollit, Ajshe Gjonbalaj, dhe nuk po më kujtohet, Sadik Jashari si duket ka qenë i fundit. Ai u dënu 15 vite burg. Ka qenë n'burgun e Pejës. Dhe kështu neve s'na mbeti tjetër, se kishim përcjellje non-stop n'shkolla. Vajzën e axhës e përjashtojnë prej shkollës, vitin e parë. Për mu mirren masat.

Erëmirë Krasniqi: Diciplinore?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Diciplinore. Domethonë, s'ke pasë drejtë me qenë anëtare e kryesisë t'klasës, kryetare klasës, pamvarsisht që sukcesi ka qenë jashtëzakonisht i mirë.

Erëmirë Krasniqi: Çfare ishin këto grupet që anëtarë e familjes juj ishin pjesë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Grupet ilegale kanë qenë të llojllojshme, LKÇK-ja, Lëvizja për Çlirim...

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj çfarë vlere promovojshin?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Vlera patriotike. Asgjë tjetër, vetëm vlera patriotike. Dhe kështu që, jemi rritë në atë frymë. Na nuk kemi pasë kohë noshta edhe me u marrë me shumë gjana lluksi. Domethonë, jemi marrë me lexime më s'shumti, me komentime, dhe çka kemi mujt domethanë moshatarve tanë t'u [thanë], "Hej libra 'Dasma' e Ismail Kadaresë osht' fenomenale, lexoje se osht' kështu, ose libra 'Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur' ose 'Fshati midis ujërave', 'Sikur të isha djal'". Në atë kohë kur kemi qenë n'filllore, edhe kështu me radhë.

Interesant, libri që mu m'ka lanë përshtypje është libri, romani parë që unë e kam lexu n'klasën e dytë, osht' "Lugjet e Verdha" edhe "Verorja", libër që asniherë nuk muj ta harroj, asniherë. Edhe libri fundit që e kom lexu tash, që e kom përfundu osht' "Gjuetari i Balonave", që është një libër (psherëtinë) *no comment*. Edhe vazhdoj t'lexoj, nuk muj [pa] lexu. Jam shumë e dashurume n'lexim, kom pasion leximin. Pamvarsisht se kushdo që më ofron ni libër, mos t'flas për librat ma herët që i kemi lexu. Ka pasë t'llojllojshme, s'muj me thanë... as vet nuk e di sa deri tani i kom lexu.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ndodhi kyçja juj në llegalen?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Krejt rasisht ka ndodhë. Ka ndodhë.... Ky djali axhës tem, hala pa u burgosë, kishin afishe, libra të ndryshme, fletushka, sikur lloj... tash m'kujtohet, tani, si lloj kampanja, me bo fushata të ndryshme, edhe disa fletushka t'vogla edhe me i shpërnda. Për shembull, kom pasë fat dhe kom pasë rastin me u njoft shumë e vogël me Halil Alidemën, kom pasë shumë fat me u njoft me Ukshin Hotin, që vlere që është.... Ai është diçka madhështore dhe qysh mos m'u motivu kur ti ke pasë shumë sene interesante që une sot ia transmetoj fmive t'mi.

Gjithmonë ai mi bike disa pamfleta, "Shko jepja bacit Halil." Unë asniherë t'u mos e ditë që kush është baci Halil, kush është baci Ukshin? A po kupton? Tanë kohën kom qenë një lloj postieri, edhe pa

vetëdije, a din, se kur e din.... Edhe kështu që hina vitin e parë shkollë t'mesme, fillova t'i kuptoj senet pak ma ndryshe. N'vit [të] dytë ma veç u futëm. U futëm. Kemi qenë, Shemsi Veseli, tani është anëtar, deputet i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Ramadan Avdiu, tani që jeton në Zvicër dhe është anëtar i PDK-së, e kështu... me këta... kemi edhe Bexhet Kelmendi, tani jeton në Suedi. Ai osht' i martum me shoqën tonë ma të ngushtën, Valbonën, që kemi qenë na qajo grupacioni. Ka qenë Afrim Zhitia, veç Afrimi, veç kjo shkon ma vonë, dikun studime viti parë, që jom taku ma s'pari me Afrim Zhitien.

Erëmirë Krasniqi: Çka bojshit, çfarë lloj organizimi keni pasë? Çfarë aktivitete?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Zakonisht i kemi pasë...

Erëmirë Krasniqi: Fletushka?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: ... po fletushka me i rregullu, kemi pasë si lloj redakte, redaksie, me ba korrektorin, korrektu se e [kemi] pasë detyrë me pa ku po i bojmë lëshimet e drejtëshkrimit. Megjithëse, kemi pasë shumë, striktë e kemi pasë mos me lëshue asniherë asni shkronjë të drejtëshkrimit të gjuhës shqipe... bile, bile Afrim Zhitia ka qenë shumë fanatik në atë aspekt. Kemi pasë... ka pasë edhe shumë tjerë, por këta jonë që na kemi, kemi bashkëpunu shumë.

Kemi bo organizimin e demonstratave të vitit '88, nëse s'gabo. Kemi bo organizimin në gjithë qendrën Prishtinës, na e kemi fillu prej Qendrës Studentëve. Kem qenë studente të vitit të parë të Fakultetit Gjuhë dhe Letërsi, Filologjik. Dhe prej atyhit fillum me ra në sy. Unë isha nihere në bisedë informative, mirëpo grupi vendosi që unë t'dalë jashtë. Ika jashtë. Kom nejt një vit në Zvicër. Jo, një vit saktësisht, po ma pak se një vit. Mas dy muje që une veç ika në Zvicër, Afrim Zhitia u vra. U vra në Kodrën e Trimave, me Fahri Fazliun. E kështu me rradhë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ish jeta e familjes juaj qeto vjet, prej '83 - '88? Disa u burgosën prej familjes së juaj?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Jo, shumë interesant osht' që në atë kohë kanë pasë dashuri mes veti shumë njerëzit, edhe t'ka majt qajo dashni mes njoni-tjetrit. S'ka pasë po më duket, noshta edhe muj me gabu, sot po m'duket gjithçka interes. Atëherë nuk ka pasë, atëhere kemi pasë dashuri mes veti edhe.... Ti imagjinoje kemi flejtë në qet', qito kushte t'dhomës {i referohet dhomës së intervistës} diku 30 vetë. Edhe respekti ka qenë jashtëzakonisht i lartë. Nuk ke mendu ti sot që ke ra me ni shok t'grupit edhe t'ka ndodhë diçka. Apsolut. Ke mujt me flejt me to pa problem edhe mos me menu ti që ty ka me t'ndodhë se je femën. Ka qenë respekti jashtëzakonisht i madh. Edhe nuk kemi mendu, bile s'kemi pasë kohë me i mendu ato sene, absolut. Përderisa i kemi, kemi pasë punë tjera.

Kështu me radhë fillum, fillum me hy edhe n'pajtimet e gjaqeve. Kom qenë anëtare e Këshillit, anëtare e Kryesisë, n'atë kohë, të Këshillit për Mbajtjen e të Drejtave të Njeriut. Pastaj, kalova në Shoqatën e

Shkrimtarëve, këtu zyret që i kanë pasë, dikun qitu të stadioni.... LDK-ja në atë kohë i ka pasë. Kom pasë fat që jom taku edhe me Ibrahim Rugovën. Kemi nejtë shumë afër. Kemi shkëmby shumë mendime dhe shumë ide.

Erëmirë Krasniqi: A e përkrahte ai llegalen? Po mendoj...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Nuk e ka ditë ai që ne kemi qenë në “llegale” në atë kohë dhe nuk na ka ra rasti shumë me bisedu. Po ni respekt i veçantë shkon për Fehmi Aganin. Ka qenë një ndër, edhe profesor i Fakultetit, i jonë, ka qenë jashtëzakonisht njeri që na ka mbështetë denjësisht.

Erëmirë Krasniqi: Çka keni studiu ju m’fal?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe. Edhe prej ktuhit vendosëm disa shokë, prej Shoqatës të Shkrimtarëve, erdhi vendimi dhe në konsultë me Havën dhe Myrvete Dreshën, që sapo patën dalë nga burgu, duke biseduar vendosëm që t’fillojmë këtë akcion. Duke pa që situata në Kosovë vijke çdo ditë edhe ma e ranë. Nuk pajshmi mo asgja që po shkon mirë.

Edhe, se edhe ni diçka harrova me e thonë... pushteti i atëhershëm, nëse ni familje ka qenë e burgosun politik, osht’ mundu që në mënyra të ndryshme... nëse në atë familje ka pasë vajza me i degjeneru në mënyra të ndryshme, nuk kanë zgjedhë mjete. Ne kemi ba këtë luftë që s’paku qato familje ça kanë fmi, me i rujtë prej ktyne gjanave. Degjenerime. U afrojshin shumë njerëz e, e shumë policë civil, e ku ta di une, kështu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: E çka propozojshin, najsen ma konkrete?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po nihere me dalë, me pi kafe, me dalë nëpër kafiteri të ndryshme, që atëhere nuk kanë qenë... domethonë, alkoholi për femna u konë absurd në atë kohë, se sot s’osht’ diçka... osht’ krejt ndryshe Erëmira, ndoshta edhe nuk muj une me përshkru qaq mirë, se ka kalu koxha ni kohë e gjatë. Pastaj, jo pse ka kalu kohë e gjatë, po ka gjana që une kom përjetu shumë edhe gjatë demonstratave kur shoktë na u vrajshin. Domethonë, kemi përjetu jashtëzakonisht rand, ose edhe kur shokut ose shoqes nuk ke mujt me ja dhonë ndihmën e parë.

Une jom një ndër personat që kam qenë edhe në grevën e minatorëve... studentat kur e kemi pasë grevën... anëtare e kryesisë, kur Surija Pupovci mbanë fjalime para studentave, shtatë ditë që kemi vendosë me u mbyllë në sallën e 25, ish- “25 Majit”.

Erëmirë Krasniqi: M’u solidarizu, apo?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: M’u solidarizu me minatorët. N’atë kohë e ka udhëheqë Fadil Kryeziu, që tani është si duket anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit. Ai ka qenë ma i vjetër se unë. Me ato kemi

pasë raporte të mira dhe kemi mujt me qëndru gjithë studentë stoikisht ni javë, shtatë ditë pa hangër, ndoshta edhe pa pi.

Erëmirë Krasniqi: A po na tregon ma shumë qysh ja filloi? Qysh ja nisi, a qysh?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Kjo ka fillu krejt rasisht. Shumë shpejtë kemi vendosë një grup, një grupacion shumë i vogël dhe shumë shpejtë jonë bashkangjitë që të gjithë studentët e konvikteve. Dhe masa veç, do me, fillojke dhe u shtojke, sa që shumë njerz na u alivanoseshin gjatë asaj kohe, se salla osht', ti e din salla sa osht' e madhe... tani thirret m'dukët "1 Tetori", po. Aq e madhe ka qenë, mirëpo kemi pasë, se dikun 20 mijë studenta i kemi pasë n'atë kohë. Tash ndoshta muj me gabu n'shifër, po ka pasë mjaftushëm studenta edhe duke mos... duke pasë shumë kurajo që neve të na bashkangjiten edhe njerëzit e thjeshtë me studenta.

Kështu që, mirë kemi nejt... ka pasë alivanosje, ka pasë... ka qenë ni, ni mbyllje, se s'mundeshim t'i hapim edhe dyert, se veç filloi Komiteti Krahinor, të asaj kohe, këtu ra, domethonë, dhanë dorëheqje. Ne kishmi frikë që po na hynë edhe policija brenda... kështu që, pak ajri ka qenë, pak ma i mbyllun se herave tjera. Dhe prej atyhit fillum, herën e fundit mo kur e kemi lëshu sallën dhe kemi demonstru. Kemi shpraz, kemi shfaqë paknaqësitë e tona se çka dojmë edhe çka nuk dojmë. Edhe kështu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh shkoi me këtë takimin?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Fillum... fillum bisedimet gjatë, kur kanë dalë prej burgut Hava, Myrvetja, osht' Flamur Gashi, që tani jeton në Shqipëri si duket, se Flamurin ka kohë të gjatë që nuk e kam pa edhe pse kemi pasë takime jashtëzakonisht t'mira, tash kemi, jemi njoftu përmes fejsbukut, shyqyr që ranë rrjetet sociale dhe tash jemi njoftu.... Ka qenë Adem Grabovci, murrëm vendime. Nuk e ditëm që do t'merr përmasa t'mëdha. U murrën vendime shumë t'vogla që ata me fillu prej Pejës me ni familje t'parë që kemi qenë, me u falë nja dy-tri ngatërresa...

Se duke e parë që Kosova, po i kanoset një rrezik i madh dhe po hyn n'luftë. Dhe qysh me hi na n'luftë me gjithë këtë hasmëri. Dhe vendosëm me u nda në zona. Pasi që kemi qenë në rastin e parë, ku është falë si duket një ngatërresë, nëse nuk gaboju... Erëmirë, kërkoj falje se mund t'gaboju këtu, rastin e parë. Po e kom inçizimin e parë çka ka ndodhë, dikun n'shpi, se shumë pak kom mujt me pshtu prej luftës fotot edhe videot që i kemi pasë n'atë kohë. Se i kom rujtë mjaft me, me ni xhelozit t'madhe.

Dhe mu, une personalisht dëshiroja me punu n'zonën e Drenicës. Dhe shpesh herë më pyesin, "Pse? Arsyeja? Pse zonën e Drenicës?" Kisha dëgju që zona Drenicës, ish një zonë që femra nuk kishte aspak të drejtë. Isha e vetmja femër me plot burra. Edhe fillun me u rritë. Pajtimi filloi me u rritë. Kërkesat ishin jashtëzakonisht të mëdhaja dhe fillum me bo rrjetin shumë ma t'gjanë. Domethonë, e përfshimë gjithë Kosovën. N'gjitha viset e Kosovës ka qenë një organizator edhe pas atij organizatori kanë qenë

persona të tjerë, deri në dhetë vetë.

Erëmirë Krasniqi: A ke spontane kjo, a?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Shumë spontane ka qenë, jo ku me ditë sa spontane, mos t'them spontane ka qenë formimi i grupacionit t'madh. Se spontane nuk ishte nëse ne vendosëm me hy në qat' familje që ka pasë një ngatërresë.... Mirëpo, e pamë që nevoja osht' jashtëzakonisht e madhe.

Kur hin me ni muhabet, o edhe qikjo po bojka, edhe qikjo po bojka, a po kupton? Edhe fillunë me u përhapë me të madhe. Pastaj, ishin kërkesat e mëdhaja. Ata njerzit vetë vijshin dhe nuk t'lejshin ty rahat. Une ika në zonën e Drenicës. Kom flejtë në Komoran tre muj. Po nuk e di, une vet kanihere e urrej veten pse jom kaq e guximshme. Shkova me ni familje që aspak nuk e njifja.

Erëmirë Krasniqi: Qysh t'pranun?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Aiii, po a din Zoti kaniherë qysh ta bjen akronin tond. Une t'u mos e ditë që çfarë familje osht' edhe hym.... Kemi qenë une... pata marrë edhe Adelina Badivukun, noshta e njëj? Përpara ka qenë, mbiemri i saj i vajzërisë...

Erëmirë Krasniqi: Toplica?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Toplica, po. Edhe tanë kohën une kom punu me Adelinën.

Erëmirë Krasniqi: Të dyjat rrijshit në atë familje?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Te dyjat kemi nejt në qat' familje. Ka qenë Fatos Gashi, ka qenë... Fatosi ka vdekë shumë i ri, Mentor Gashi, vllau i tij. Pastaj na u bashkangjitë i zoti shpijës...

Erëmirë Krasniqi: A ishit krejt të Prishtinës ju, a qysh?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Krejt të Prishtinës, Prishtinës... Fatosi ka qenë i Klinës, por student në Prishtinë, pastaj ka qenë Agim, i Pejës, edhe ai student në Prishtinë. U bonëm kështu një grupacion jashtëzakonisht i mirë edhe që vendosëm që kudo që t'shkojmë, domethonë, me i dalë kësaj pune deri n'fund.

Adelina ka qenë shumë e vogël, po shumë kureshtare. Ka shkru shumë poezi t'mira. Se edhe unë jom marrë me shkrime edhe tanë kohën m'pytke, "Hajt bre, se ti si profesoresha jem po m'bohesh, a osht' qikjo e mirë?" "Po, Adelinë. Hiç mos ta nin!" Se si fmijë u konë shumë e mirë, edhe Adelina rrjedhë prej një familje jashtëzakonisht t'mirë. Une jom konë n'shpi t'sajna, kom nejt, kom flejtë. Se Adelina ka qenë edhe e helmume n'atë kohë. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: A ishte ajo n'fakultet në qat' kohë a?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Jo, nxanse u konë, e re u konë. Adelina osht' ma e re se une shumë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u takut, a qysh?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: U takum krejt rasisht në Shoqatë të Shkrimtarëve, në LDK. Ajo vjen si vajzë e re. A e din, kur vijnë vajzat e reja plot emocione, plot entuziazëm. Edhe m'ka pëlqy Adelina edhe nuk kom dyshu asniherë për arritjet e saja sot ku osht'. Ne nuk jemi pa prej atëherit asniherë. Mirëpo, komunikojmë n'fejsbuk. I shkrun vajzës teme shpesh herë i thotë, "A i ke ngja nanës a jo?" Edhe kështu me radhë.

Edhe vendosëm, shkum. Shkum në Komoran te familja Bislim Zogajt. Bislim Zogaj tani është deputet i parlamentit të Kosovës, është.... Pse na presin aq mirë edhe aq ngrohtësisht, kurrë n'jetë s'kisha besu, në Drenicë. Ma la ni përshtypje që Drenica është krejt ari.

Erëmirë Krasniqi: Ju kurrë s'kishit qenë më përpara?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Jo, nuk kam qenë asniherë më përpara. Edhe fillum.... Atë natë bujtëm aty. Nona e Bislimit edhe baba i Bislimit, nona Bislimit na boni bukën. Na ishim dikun, unë... dikun shtatë vetë, plus baci Anton ishte me neve, ishte Mujë Rugova me neve, ishte Shefqet Canhasi me neve, ishte profesori Murat Bejta n'atë kohë, Shefqet Pllana, a po? Profesor i Institutit Albanologjik.

Edhe na bujtëm atë natë aty. Edhe baci Anton, si baci Anton, ka qenë njeri shumë i qetë. Edhe po thotë, "Hë, lbe, a do me nejt këtu? A ki frikë?" Thashë, "Jo, aspak, une do të, kom vendosë," thashë, "edhe kem m'i dalë kësaj pune". Po, shumë interesant. Filloi puna, filloi takimi me njerëz.... Eh, familja Bislimit ishte shumë interesante. Shumë dallim i madh me familjet e tjera.

Erëmirë Krasniqi: Në çfarë kuptimi?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Këta ishin ma intelektual, ma të ngritun. Ndoshta edhe intelektualisht ma të ngritun. Fillum me dalë nëpër zona shumë më t'thella t'fshatit. Ishte shumë problem se aty ndodhi ni gjak, ngatërresa. U falke vetëm prej një njeriut. Për shembull, na i kemi pasë në Gradicë dikun 18 gjaqe, tetë ngatë... tetë plagë edhe dikun dymbëdhjetë ngatërresa prej ni njerit, ngatërresa, prej ni njerit u falke. Shumë interesant ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë sistemi ish ky i drejtësisë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po ata e kanë nda drejtësinë vet se n'bazë të "Kanunit të Lekë

Dukagjinit”.

Erëmirë Krasniqi: Po de, po një person me vendosë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Qashtu, një person ka vendosë. Edhe na fillum me hy nëpër shpija. Me hy femna {tund kokën} shumë problem e kemi pasë.

Erëmirë Krasniqi: A ishin këto pasoja që Jugosllavia e ka lanë mas ekonomikisht regjionin e Drenicës, apo?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, sigurisht. Po qysh s’i ka lonë? Po, i ka lonë se, se thotë një fjalë e popullit, “Sundo e përçajë”, kjo ka qenë motoja. Edhe po them me përgjegjësi t’plotë që asni rast nuk ka qenë pa i lidhë me pushtetin. Domethonë, “Sundo e përçajë”.

Erëmirë Krasniqi: E qysh...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: E sidomos nëpër zona....Po dihet që zona e Drenicës ka qenë ni ndër zonat ma t’prekshme gjatë dy Luftërave Botërore. Na e dijmë mirë [është] damtu, damtu tej mase. Edhe shpijunazha ma e madhe noshta ka qenë aty, se zakonisht pasojat lufta i lenë këta persona. Ka qenë, ka pasë raste tmerruse që shpesh herë mendoja a po jetoja në Kosovë, apo jo! A po jetoja dikun në Afrikën e Veriut ose të Jugut.

Erëmirë Krasniqi: A na tregon naj rast?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Rasti në Kishna Rekë, osht’ ni rast jashtëzakonisht i prekun. Na thirrin urgjent, qet’ rast, edhe shkum unë, Adelina edhe Agimi, edhe baci Anton m’duket ka qenë. Edhe t’u i ndëgju, t’u e ndëgju storjen e atij zotrisë... se pajtimi i gjaqeve ka qenë shumë interesant kur u bo llajv [drejtëpërdrejtë], jo mas kamerave... se osht’ bo një punë jashtëzakonisht e madhe. O shku noshta dhejtë herë te qajo familje deri sa osht’ kry, pastaj ka dalë publikisht. E ajo, ajo natyralja mu m’ka pëlqy gjithmonë se e ka pasë edhe emocionin e vet. Ka pasë lot. Herë- herë të hidhërimit, herë-herë të gëzimit. Ka pasë fyrje, ka pasë lëvdata. Ka pasë lloj-lloj gjanash. Ka pasë edhe prekje t’jashtëzakonshme.

Po na thirrin në qet’ rast, edhe shkum. Veç na njoftun që osht’ rast jashtëzakonisht i ranë. Harrova me e përmend që n’kto raste, n’kto pajtime në Drenicë na u ka bashkangjitë edhe Gjenerali Ushtrisë Çlirimtare, plaku, Xheladin Gashi, që për asni moment neve nuk na ka lanë n’zonën e Drenicës vet. Bislim Zogaj edhe Xheladin Gashi ka qenë non-stop, natën, ditën, ku është kërku. Plus asaj, familja e Bislimit i ka pasë në dispozicion edhe tri vetura, që na kah jemi shku, domethonë, na u ka siguru ecja. Ecja, ose vozitja, ose.... Na nuk e kemi pasë problem a mujna me mrri në Tërstenik, se ka pasë jashtëzakonisht fshatra malore, ajo ka qenë krejt problem i zotit t’shpiisë që kemi flejtë aty.

Edhe t'u e ndëgju rastin që ishmi në Kishna Rekë, imagjinoje ti, burri pas 20 vjete i lyp dëmshpërblim grusë, familjes t'grusë. Edhe, "Për çfarë arsye, ça i ke bo grusë?" Kur shkum te familja tjetër tash, te e dëmtuara, qashtu i kemi qujtë, familja e dëmtume, tregon baba i vajzës, thotë, "Ma ka djegë me cigare". T'njejtin rast e kemi pasë dikun edhe në Llap. Masi se... kur i kom kry une këtu pajtimet, kom kalu në Llap edhe në Pejë. Veç n'vend tem s'kom punu n'atë anë, që jom martu tash. Ka pasë raste që...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke, çfarë damshpërblimi kërkojke burri për grunë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po tash për arsye që.... Nuk tregojke pse e ka myt grun e vet...

Erëmirë Krasniqi: Ah, e ka myt?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po me hekur, me cigare, me hekur. Tregojke tani baba i asaj vajzës. Se na shkojshmi e ndëgjoishmi, për shembull njerin që e ka kry aktin, pas asaj shkojshmi e ndëgjoishmi edhe të dëmtuarin. Se ti pa i ndëgju të dy palët, edhe pa e marrë dikun tjetër prej asaj familje... ose t'ka vnu kusht, "Unë du me pasë Rexhep Qosjen". O dashtë me ardhë në Institut me marrë. Uhh, sa herë e kemi marrë Rexhep Qosjen, Rexhep Qosjen, Shefqet Canhasin. Kemi marr shumë, profesorin Murat Bejtën, shumë kemi pasë. Emin Kabashin, që asniherë nuk na u nda, profesori që osht'... Shumë, s'di, s'kom fjalë për profesorin Emin Kabashi. Asnihere nuk na ka lonë vet. Zakonisht na ka thirrë, "çikat e mija". Edhe kështu përfundoj, ky rast.

Erëmirë Krasniqi: Sa herë keni shku edhe a është falë ky rast?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Njo dhetë herë jemi shku, edhe po, është falë. Nji rast tjetër ka qenë në Tërstenik. Ni plak, gati para vdekjes ishte. Edhe nuk na pranoj mrena. Po na nje me thupër. Po ju thotë djemve t'vet e.... T'u bo... na kemi insistu zakoni, vazhdimisht edhe hym mrenda. E kish pasë shqiponjën e madhe {tregon me duar}. Shqiponjën. Shumë patriot. Edhe gjatë bisedimit, e bisedimit, e t'nervozohna une. Thashë, "Hiqe këtë shqiponje, ti s'koke burrë!" Kap shqiponjën, edhe t'ja shkeli, thashë.... E tëm qiti jashtë, e nuk m'pranoj mo hiç.

Mas ni jave, kanë qenë grupacione të ndryshme. Tha, "Ja," tha, "pa m'ardhë qajo çika," tha, "une veç qasaj kom me ja falë," tha, "tjetër kujt jo". Bile i kom fotot, ta tregoj. Edhe kanë marr pjesë tani edhe televizione të ndryshme n'atë kohë. Edhe shkova. "E pse axhë bash ksajna?" Tha, "Eh, për me hjekë shqiponjën prej atyhit," tha, "duhet me pasë koxha forcë".

Erëmirë Krasniqi: E çka ishte rasti?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Rasti, krejt vrasje. Vrasje, vrasje, vrasje. Edhe krejt për mexha. A din, nuk

ke pasë naj vrasje t'motivit moralit, absolut jo. Po, ja vrasje për mexha... "Ma ka marrë ni metër knena". Une po t'thom që këtu, "Sundo e përçajë". Krejt shteti ka marrë pjesë, pushteti atëhershëm. Gjithmonë.

Rasti tjetër që unë e kom shkru shkrimin tem, osht' nona Hajri në Llapushnik. Osht' ni rast shumë i prekshëm. Kur na kanë thirrë me shku n'atë, n'atë vend, na kanë thanë që nuk muni me shku shumë njerëz. Edhe t'u e pa situatën kur e tregoj, kur e tregunë njerëzit, une vendosa me marrë Adelinën edhe profesoresha Drita Statovci. Edhe shkum na trija... na shkum shumë njerëz, mirëpo, shkum na trija hynëm mrenda.

Katastrofë. Çka t'shijhe n'atë shpi? Fmitë po lunin jashtë. Dhe shikimi i tyne ishte jashtëzakonisht interesant. Sigurisht pyetshin, "Kush janë këta, pse kanë ardhë, ç'dojnë p'i neve?" Dhe shumë interesant, si jemi hi, jemi ulë, a din plaka {imiton plakën me lëvizje duarsh}. Na e kuptum menihere, profesoresha Dritë bile po thotë, "Ibe, mos e zgjat shumë". N'atë kohë une jom thirrë me nofkën Ibja. Dhe ajo e kuptoi pse ishmi ardhë. Dhe tha, "Unë kërk..."

Erëmirë Krasniqi: Çka ju kish ndodhë atyne?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Atyne ju kishin ndodhë, ishin vra dy djem me sopatë. Dhe gjymtyrtë i ka mbedhë vetë nana vet.

Erëmirë Krasniqi: Kush i ka vra?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Ha?

Erëmirë Krasniqi: Kush i ka vra?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: I ka vra kojshiu, që u.... Prej qatij rasti tani edhe dy-tri raste tjera ishin të ndërlidhura, t'u marrë hakmarrje, a kupton, që u dufte t'falen disa vrasje po edhe disa gjaqe që ishin plagosun njerëz. Ajo u qujke nona Hajri, dhe nona Hajri e kishte vetëm ni djal që ne nuk e dinim. Dhe po na thotë, tha "Unë e di," tha, "pse jeni ardhë". Tha, "Mirëpo, kam një kërkesë nga ju, që ju t'ma pritni", edhe gjysë ore ishte puna, "me ardhë djali prej punës".

Edhe na vendosëm që, "Po, okej. Kemi me pritë". E kom punimin n'libër, qi dush munesh me lexu, ose muj me ta lexu, nuk o shumë i madh. Edhe vjen djali. Edhe ai e kuptoi pse ishmi ardhë, se kishte shumë vetura jashtë, ishin profesorat e nderum. Edhe vendosi tha, "N'emër të juj, n'emën gjakut që osht' derdhë, fali gjakun e dy vllazërve. Nuk ka qenë e lehtë aspak, është bo, është derdhë shumë gjak aty. Bashkë me ta edhe na". Mirëpo, është rasti që me herën e parë është falë. Nuk ka kërk me shku...

Erëmirë Krasniqi: E ku e gjetën ata atë forcë përneherë me falë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Shumë ndjenjë interesant.... Po historia na tregon që femnat jonë koxha burrnore.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, nana Hajrie ka falë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Nana Hajrie, po, nana Hajrie, edhe koxha sfiduse n’jetë. Kështu që, une nuk jom shumë feministe, veç e përkrahi...

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na spjegu qat’ farë, që the që një njeri vendoske a falet një gjak a jo? Çfarë mentaliteti ishte instalu?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Mentaliteti jashtëzakonisht i ulët.

Erëmirë Krasniqi: Kush ish ai njeri? Çfarë vlere shoqnore u dufke ai me pasë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Ai u dufke ni njeri i vjetër, që kish ni mjekërr deri këtu {tregon me dorë afër gjoksit}, edhe folke.... Tash une e pata lexu “Kanunin e Lekë Dukagjinit”, edhe n’bazë të “Kanunit të Lekë Dukagjinit”, bile femna nuk duhet të hyn në odën e burrave absolut, e lëre mo që n’atë kohë une në odat e Drenicës kom gjetë oxhakun, kupronë, edhe kashtë knej, kashtë anej, në mes ka qenë ecja. Domethanë, tamam e kemi, e kemi provu dhe përjetu jetën e shekullit, që as vet s’mund ta mendoj. Që se kisha pa n’jetën time asniherë. As andrru jo, se lëre mo për ta pa, po as ëndrru jo. As absolut nuk mujke, nuk mujsha me konceptu trunin e tyne, në çfarë gjendje jonë ata njerëz kështu.

Erëmirë Krasniqi: Aq arkaike ish jeta në Drenicë a?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Hë?

Erëmirë Krasniqi: Aq arkaike ish jeta në Drenicë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Për besë, po. Dhe kur jom shku tani e kom pa një befasi jashtëzakonisht për t’mirë, domethonë, njerëzit kanë fillu me u shkollu. Niveli i tyne ka qenë jashtëzakonisht... tash niveli tyne osht’ i lartë. Atëherë ka qenë... shumë pak femna jonë shkollu, mos t’thom fare. Domethonë, i ke njeh n’gishta. Edhe për qata e ka bo, niveli i ulët i vetëdijes njerëzve, edhe dijes, konceptit të dijes, e ka bo që njerëzit me qenë qaq të ulët. Edhe s’ka, qiky njeri falë edhe tjetër absolut. Ose nëse ka qenë para vdekjes e ka eduku fmiun e vet që, “Ti duhesh patjetër me marrë hak, me vra filanin”. Ka shku vrasje pas vrasjes, se di a jom e kjo? Edhe ajo, te ajo vrasje ka mrrri noshta deri n’tetë shokë.

Erëmirë Krasniqi: Edhe, sa ishin të vjetra këto rastet zakonisht, ju që i pajtojshit?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po ke pasë raste 20 vjeçare, 25, se ke pasë të ndryshme. Ke pasë edhe n'burg që ka vdekë raste, të ndryshme ke pasë. Ka pasë të frikshme, domethonë tri vjet, pesë vjet. Ke pasë rastin e fundit te Verrat e Llukës që vajza ka mbetë me falë gjakun e babës edhe dy vllazërve, që u konë ni rast specifik. Edhe kështu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ju thojshit ktyne njerëzve për Kanun, po menoj diçka pak ma specifike?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Zakonisht për Kanun kanë fol profesorat...

Erëmirë Krasniqi: Çka ju thojshit për Kanun, meqenëse paska qenë aq i fortë në atë rreth?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Kanë fol profesorat, kanë fol profesorat...

Erëmirë Krasniqi: Çka ju thojshit për me ndërru pak perceptcionin rreth Kanunit?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po ata zakonisht janë nisë me nocionin që këtë, këtë akcion e kanë fillu njerzit e burgosun, njerzit që kanë vujtë shumë, njerzit që po vujnë edhe tani. Po shihet që situata po rrezikohet ditë pas ditë. E pajshin që policia neve na përcillshin, na ndjekshin besa, po nuk mujshin me na zonë. Edhe i pajshin ata edhe vet, edhe krejt n'qëto, n'qëto skena, n'qëto raste u dashtë me u bazu për me i bindë ata që duhet me u falë se veç lufta po fillon. Na t'u mos e ditë që sot veç... filloi lufta. Edhe kështu, ka pasë... mos meno Erëmirë që ato raste janë pajtu qaq lehtë. Ka pasë punë koxha të madhe...

Erëmirë Krasniqi: Edhe qysh... prej çfarë barre u shlirojshin njerzit kur falshin, kështu pak ma specifikisht? Çka ke pa ti, çfarë lloj shlirimi vrejshit?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Ata kur bojshin faljen, ka qenë shumë e vështirë kur ka thanë, "Po, p'e fali", edhe kanë fillu me qajtë. Se shpesh herë na thojshin ne, "A kishe mujt ti me bo?" A din? "Por për hirë t'ktyne t'rive që po kanë gjithë këtë vullnet, për hirë t'ktij akcioni në emën t'gjithë këtyne akcionarve që janë t'u punu, duhet me ba". Na shtishin edhe në pozita jo t'lakmushme edhe neve. Kanë qenë me t'vërtetë raste t'rana. Edhe gjithmonë t'u u nisë prej qetij aspekti, lufta po fillon, duhet me u përgatitë, na me dalë n'luftë na duhet m'u myt mes veti s'pari edhe tani me marrë pushkën me luftu me armikun. Dikush u bindke, dikush më vonë, dikush më herët. Kështu me radhë ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Këta që u bindshin a ju doke mënyrë ma e ndershme me i ik vrasjes t'tjetrit? A ish ma lehtë për ta se s'kanë nevojë me vra kërkon? A din...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po...

Erëmirë Krasniqi: ... a kish edhe asi raste kur njerzit nuk kanë pasë qef me vra?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po ka pasë raste. Une, më kujtohet rasti jena konë dikun në dy të natës, në Prekaz na kanë thirrë. U konë ni rast jashtëzakonisht i ranë që as fmitë n'shkollë s'i kanë lanë me shku.

Erëmirë Krasniqi: Të ngujumë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Të ngujumë, domethanë. Kemi pasë, ka pasë raste të tilla koxha si shumë. Edhe kemi shku prej orës tre deri në ora gjashtë t'mëngjesit o dashtë me ndejtë komkryq, se përndryshe ti nuk ke mujtë me hi n'odë. M'u ulë komkryq si burrat. Po, për besë! Edhe falë profesorit Anton edhe profesorit Murat Bejta ka qenë m'duket, ka qenë edhe profesori Shefqet Pllana, nëse s'gaboje në qat' rast... edhe e fitum rastin, morrëm besë për shtatë ditë.

Erëmirë Krasniqi: Për sa?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Për shtatë ditë.

Erëmirë Krasniqi: Për shtatë ditë.

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po. Edhe, pas ni kohe... se n'atë pjesë punojke, punojshin akcionarët e tjerë t'pajtimeve... e i njoftum që qështu, qështu osht' rasti, mirëpo prapë se prapë me interventat, me intervencat e tona, prapë duke shku me ju ndihmu të tjerve edhe në Skenderaj, veç ai rast u përfundu.

Erëmirë Krasniqi: A ndikojke kjo që ata me u varfnu ma shumë, fakti që ishin t'ngujumë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, normalisht që varfnoheshin në shumë mënyra. Varfnoheshin edhe në mënyrën e dijes, se jo-shkollimit, edhe në mënyrën e punimit të arave edhe t'fushave. Se ishin kohë për shembull, koha e verës e pranverës mbjellja e shumë gjanave elementare për jetë. Edhe ata, n'qato sene u dufke patjetër me u bazu se me pa, me pa që s'ki bukë me hangër, e kur s'ki bukë me hangër edhe ujë me pi... se ujin ata mrena nuk e kanë pasë. O dashtë koxha larg me shku deri te kroni për me mushë ujë. Aty tani s'ke pasë siguri mo! Aa po ta vranë djalin, a po ta vranë grujën, a kon po ta vranë?

Erëmirë Krasniqi: A jonë vra edhe gratë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, janë vra edhe gratë.

Erëmirë Krasniqi: Për me nxerr gjak a?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, për me nxerr hak.

Erëmirë Krasniqi: Po, a mujm me ju kthy qatij rastit kur njerzit nuk kanë, nuk kanë dashtë me vra e që kanë mbet të ngujumë për shkak t'qasaj? Qat' rastin që e keni pajtu?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, ka raste, nuk është veç ni q'ai rast në Prekaz që ka ndodhë. Kanë ndodhë edhe tjera raste nëpër Drenicë që nuk kanë pasë qef me dalë me marrë hak. Pamvarsisht, ma e keqja e t'keqes ka qenë që këta kanë pasë trysni tani prej rrethit ku kanë jetu. "Qe, s'po guxon", a kupton? Lloj-lloj presionesh veç me shty...

Erëmirë Krasniqi: Me nxitë...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Me nxitë, domethonë. Edhe pushteti në atë kohë e ka pasë shumë, shumë ma lehtë me ndiku, se e ka nxitë, e ka nxitë shumë. E njeri i ka thanë, filani për shembull, që na i marrshim informacionet që ai punon në SUP [Sekretariati i Punëve të Brendshme] në atë kohë, seriozisht po, edhe e ka shty me bo qatahën. Shumë ka qenë, sidomos në Drenicë ka qenë pjesa shumë e dëmtume. Une jom e kënaqun shumë që sot ndëgjoj, kur shkoj e vizitoj, dëgjoj që shumë gra sot e shumë femna punojnë, jonë intelektuale, jonë.... Në atë kohë u konë koxha problem.

Erëmirë Krasniqi: A keni majtë tubime në Drenicë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, kemi majtë, në Drenicë, po. E kemi, edhe në *youtube* e kom pa, që kemi majtë takime ku jonë falë gjaqet. Mirëpo, krejt përfundim, përfundimtaren e kemi pasë te Verrat e Llukës. Po, kemi majtë dy a tri po m'duket, edhe në Drenicë i kemi pasë.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, ju po flisni për këtë periudhën shkurt –maj?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po.

Erëmirë Krasniqi: 1990?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Qashtu.

Erëmirë Krasniqi: Okej. A po m'tregon qysh e përmbyllët këtë punën n'teren në Drenicë edhe qysh vazhdove mandej me Pejë, e me Llap?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po. Masi që mendum që i kryjtëm të gjitha rastet, megjithëse ne nuk e përmbyllëm, se nuk ishte diçka që mund të përmbyllet se nevojat ishin shumë të mëdha. Ndoshta, s'po di... baci Anton e ka pa te une që une jom pak ma kambëngulëse, edhe kur kom vendosë diçka me ba, pa e shku dej n'fund s'kom mujt me kry. Shpesh herë ma tërhiqke vërejtjen, "Ibe {bën me duar kinse më ngadalë}". Thashë, "Jo, une ty me t'ngu duhet me flejt baci Anton". Se ai krejt me të mirë i

merrke, krejt. Shpesh herë ka pasë raste që me t'vërtetë ja ka vlejte, edhe që ka qenë prezent, edhe... se njerëzit e kanë respektu shumë në Drenicë, bacin Anton. Jashtëzakonisht shumë...

Erëmirë Krasniqi: Se i ka studju?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, ka studju edhe i ka pasë ato...

Erëmirë Krasniqi: Thanjet...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Proverbat e veta. Kështu që, na kemi pasë një kënaqësi shumë t'madhe që e kemi pasë bacin Anton prezent.

Erëmirë Krasniqi: A e njifshin njerzit atje?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Ha?

Erëmirë Krasniqi: A e njifshin?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, e njifshin, e njifshin. Disa e njifshin, patjetër. Bile e kërkojshin. Kur shkojshmi na në disa raste s'na pranojshin, "Jo, bacin Anton". U dufke me marrë ate. Ndoshta me ardhë në Prishtinë me marrë, ose nëse ka qenë të Bislimi me marrë. Kështu ka qenë, ka qenë n'atë kohë.

Edhe une... se na zakonisht jemi ndihmu mes veti, nëse m'ka thirrë Peja, jom shku me ni rast që ata kanë menu që une muj me dhonë kontribut. Po edhe une kom mujt me i thirrë në Drenicë, kur e kom ditë ndoshta që Myrveti ose Hava ka mujtë me dhonë ni kontribut. Kështu që, nuk jemi kursy mes veti. Se na jemi njoft që të gjithë. Kryesorja, kryesorët jemi njoft na, edhe nuk ka pasë problem. Kom qenë edhe në Llap edhe në Pejë. Në Pejë kom marrë pjesë me ni rast (psherëtinë)... m'ka ikë emri i fshatit. Aty jemi taku me Flamurin, Flamur Gashin.

Erëmirë Krasniqi: Isniq?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Ja-a. M'bjen n'mend ndërkohë, po besoj. Po m'vjen keq, kërkoj falje, po...

Erëmirë Krasniqi: Jo, jo, kurgjo.

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Mund të ndodhin tash këto. Edhe aty e kemi kry qat' farë, aty e kemi kry ni falje t'gjakut. Edhe aty u kanë shumë interesant. N'qatë kohë që kom nejtë atje m'kanë thirrë në Llap. Profesor Shefqet Canhasi me profesor Murat Bejtën, ata kanë punu n'qatë zonë. S'e kanë lëshu, veç noj rast që i kemi thirrë na, kanë ardhë edhe ata edhe kanë marrë pjesë me neve. Edhe

përfundimtarja ka qenë të Verrat e Llukës, edhe s'do...

Erëmirë Krasniqi: A dallojshin... para se me dalë atje, a dallojshin rastet prej regjionit në regjion? Natyra e rasteve?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, ka dallu shumë. Ke pasë raste, për shembull, rasti i nonës Hajri mu m'ka prekë ma s'shumti. Ka pasë edhe raste ma të rana, po që mu rasti i nonës Hajri m'ka prekë shumë se ka tregu shumë bujari, nuk na ka rëndu, nuk na ka fy. Na ka pranë n'shpjën e vet n'qato kushte qysh ka qenë. Ajo m'ka lanë mu shumë, m'ka lanë mbresa. Edhe m'ka ba përshtypje, edhe sot e kësaj dite m'bon përshtypje, që ne femnat jemi ma t'guximshme edhe nuk mund t'korruptohemi lehtë. Unë kështu besoj, se vetë të qenit femër, jemi ma të ndishme, ma ndryshe se gjinia mashkullore.

Erëmirë Krasniqi: Mendova ma shumë, për shkak se regjione të ndryshme kanë pasë edhe mentalitete të ndryshme. A ka ndiku kjo që edhe rastet...

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Drenica dhe Peja, ana e Pejës, normalisht që kanë qenë, rastet ma të randa i kanë pasë. Se mo s'po flas për Kanun, për anej kah Rugova, se atje dihet kryekput Kanuni ka pasë... e ka, e ka... ka dominu n'çdo aspekt. Ndoshta ti në Drenicë ke pasë hapsirë, ata në zonën atje e kanë pasë ma.... Une menoj që në gjithë rrezën e Kosovës, n'nivel të Kosovës, Drenica edhe ana e Pejës edhe Dukagjinit andej ka pasë rastet ma t'rana.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë, kanë dallu?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, qysh jo, qysh s'ka ndrru. Ana e Gjilanit ka pasë, une s'po thom që s'ka pasë, po jonë kanë rastet pak ma të, ma të buta. Llapi ka pasë, po nëse hym veç n'thellësi ka pasë raste pak ma t'ronda, mirëpo jo qaq shumë t'rana. Se normal, vdekja prej vdekjes shumë dallon. Kemi pasë për shembull rastin e ni fmijës, e kish pasë shkelë njani me kerr, në Prishtinë. Kemi pasë dikun te Vranjenci, bile aty kom qenë kur ju ka dhanë edhe emri i ri Vranjencit. Edhe, ai ka aludu që ja ka myt ai me kerr, edhe kur dalin n'gjykatë, fmija, kur bohet obduksioni, fmija kish vdekë para ndeshjes. Po, se e ka lëshu shpirti, a ku e di une. Edhe tash aludojke n'qata, "Jo, ma ka myt me qëllim". A e ke pa shqiptari pak si t'hin llugave e tani s'din me dalë.

S'munet njerin me myt kërkush me qëllim, s'ma kap truni. Ani ma n'këtë kohë, n'shekullin e 21, absolut. Megjithëse, hala ka raste. Jonë ma t'ralla. Kërkojnë. E ne prej atyhit, prej Verrave të Llukës kur është mbyllë, nuk kemi ndërhy mo naj rast, se është përmbyllë krejt ai...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke te Verrat e Llukës, a po m'tregon? Cila është ni përvojë personale?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Te Verrat e Llukës ka qenë befasia ma e madhe në jetë, që muj me bo, "Uau", është Verat e Llukës. Se vet prezenca e gjithë atyne njerzve, gjithë ajo përkrahje prej atyne

njerzve, ty veç t'bojke m'u ni krenar, e më krenar. Veç m'i pasë ata fletat e shqiponjës edhe me ecë.... Edhe krejt rrethum ka qenë [me] policë, n'autoblinda, besa edhe n'tenka. Edhe nuk dishe m'u... nuk kishe as... në asni moment frikë që ty ka me t'gjujtë dikush. Ajo m'ka lonë ni përshtypje jashtëzakonisht t'madhe.

Pjesa e Dytë

[Folësja vazhdon rrëfimin nga pjesa e parë e intervistës]

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Në mëngjes kemi pasë zakonisht takimet para Institutit Albanologjik, une, Adelina, Fatosi, Mentori, Agimi. Prej atyhit vazhdojmë edhe shkojmë. Rugës ka pasë autoblinda çdokun. Çdokun. Po nuk m'kujtohet mirë edhe profi a ka qenë me neve, profi Hajrullah Gorani. Kemi pasë, jemi nisë dikun pesë vetura si duket. Me kënaqësinë ma t'madhe, kangë patriotike sa t'dush që me t'motivu pak. Edhe kemi mbërri te Verrat e Llukës mas shumë peripetish t'u ik nëpër rrugë të ndryshme se s'kishim mundësi absolut me mbërri deri n'vandin. Mirëpo, fati që na e kishmi njërin e Pejës në veturat tona dhe ai dike ka jonë, ka mujnë anej me shku se na nuk e dishmi atë...

Erëmirë Krasniqi: Ju ka mësu rrugën?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj:... rrugën, po, rrugët, n'ato rrugët e Pejës. Edhe pa hy në Pejë hiç ti prej Prishtinës ke pasë tanë kohën autoblinda. Polici që t'ka pyt, "Ku po shkon, pse po shkon, ku je nisë?" Ta ka lyp letërnjoftimin, "Ti je i Prishtinës?" Edhe kështu ka qenë biseda të ndryshme që shumë... e njerëzit i kanë nalë edhe për mos me shku. Mirëpo, s'kanë mujt me arrit se Verrat e Llukës u mush, bile u stërmush. Diku parashihet pesë qind mijë njerëz kanë qenë prezent.

Ka qenë një ditë plot jetë. Noshta kemi shku edhe për me vdek atje, po fati që po jetojmë sot. Se absolut se kemi menu që kemi me vdek, edhe nëse vdesmi osht' gjaja ma e mira n'botë që mujna m'i ja dhonë Kosovës. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: Sa gjaqe jonë falë?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: N'përgjithsi?

Erëmirë Krasniqi: Po menoq qat' ditë?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Jo qat' ditë jonë falë, jonë kap gjitha gjaqet n'nivel të Kosovës, aty jonë shpallë.

Erëmirë Krasniqi: A jonë prezantu krejt?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Jonë prezantu t'gjitha gjaqet. Përpos që kanë pasë nashta edhe naj gjak që e kanë falë shumë shpejtë, afër, aty jonë prezentu gjitha gjaqet.

Erëmirë Krasniqi: Krejt rastet që jonë falë deri në atë moment janë prezantu aty?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Po krejt rastet qa kanë... Verrat e Llukës ka qenë edhe përmbyllse.

Erëmirë Krasniqi: Desha me t'pyt edhe diçka personale. E përmende që ju jeni, si studente jeni solidarizu me at' grupin e minatorëve...

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Po.

Erëmirë Krasniqi: ... edhe, edhe ata e përmendin pajtimin e gjaqeve. A ka qenë naj referencë direkte me minatorët? Iniciativa...

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Po ka...

Erëmirë Krasniqi: ... e pajtimin?

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: ... po ka dalë edhe prej atyhit. Se, thujse shumë që kemi qenë aty, na veç kemi qenë nismëtarët e parë t'pajtimeve t'gjaqeve.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj, a jonë inspiru edhe prej minatorëve, nëse ata kanë pasë lidhje me...

Ibadete Bunjaku - Ahmetaj: Po, qysh jo.... Jemi inspiru gjithmonë prej tyne se kanë bo thirrje non-stop. Kemi bo edhe thirrje edhe ne me ta edhe i kemi përkrahë ndërkohë, se nëse, ti je ndoshta ma e re, po nëse din se një delegacion prej atyhit ka shku me i vizitu minatorët në Trepçë. Ka qenë Fadil Kryeziu n'krye me ta që u shku dhe u solidarizu dhe osht' kthy, i ka tregu studentave. Kemi qenë diku pesë-gjashtë vetë. Unë nuk kom qenë poshtë n'zgafellë. Fadili ka qenë me nja katër djem tjerë si duket...

E normalisht se krejt këto jonë motiv. Motiv ti merr pak aty.... Ndoshta një rroj e policit, gërbaq ktyhiherë që i ka thonë, ke hongër n'shpin, qajo ty t'ka motivu për me luftu kundër tij. E mos t'flasë mo minatorët që kanë qenë motivi ma i madh, sa ditë t'mbyllun n'horizontin e nantë, tetë, pa hongër, pa pi, osht' koxha... veç shiptartë e bojn kto. Ne veç njifemi n'histori botërore për këtë, këtë gjest.

Erëmirë Krasniqi: Kur përfundun, a përfundun edhe për juve pajtimet, a vazhdut ju hala me aktivitete?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Jo, nuk kemi pasë ndonjë aktivitet që vlen me cek. Ka pasë ndoni rast aty-ktu, edhe pse Verrat e Llukës kanë qenë përmbyllse, por ka pasë. U kërkoshmi edhe nga ana e policisë non-stop. Ti ke qenë i përndjekur. Unë e kom hospitu edhe rastin e rektorit të Universitetit, kti katolikut...

Donjeta Berisha: Marjan Demaj?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Marjan Demaj. N'familje t'tij kom qenë, unë personalisht, Bislimi, kemi qenë.... Që ja kanë vra dy vllazërit. Nëse e kom listën qaty, n'listë i kom t'shënume nuk i di saktisht. Edhe rastin e tij, kemi qenë dy-tri herë dhe ja kemi lonë Klinës anej, se ky në Malishevë si duket ka qenë, dikun afër Malishevës, afër Klinës. Edhe ja kemi lonë rastin Klina mu marrë me te.

Erëmirë Krasniqi: A ishit e përndjekur ju masnej, mas pajtimeve?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po...

Erëmirë Krasniqi: Apo ecshit lirë mandej?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: ... jo, shliër, absolut. Absolut, asniherë s'kena mujt me nejt shliër. Gjithmonë i kemi pasë disa tjerë që neve na kanë përcjellë me na pa në çfarë gjendje jemi edhe me na mbrojtë. Tanë kohën. Se shliër s'ke mujt... ani mo unë që kom qenë edhe koxha n'sy prej familjes.... Po u martova dhe jau hupa [fijen] tani. U martova n'vitin '93. Jam martu n'fshatin Hogosht. Kom katër fëmijë, dy vajza dhe dy djem, ku vajzën e madhe e ka pagzu baci Anton me emrin Urata.

Urata është studente e Fakultetit të Arkitekturës, vitin e katërt. Doruntina osht', ka kry Fakultetin e Gjuhës Angleze, tani po vazhdon prap Fakultetin Juridik, vitin e dytë. Atdheu osht' maturant sivjet, nesër e ka mramjen. Dorantin e kom, djali më i vogli osht' n'klasën e dhetë. Është futbollist, portier i Prishtinës me U17, dhe që n'këtë moshë është frymëzu, ndoshta edhe prej meje, edhe denjësisht po na përkrahë edhe në U17-shin e Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishin të '90-tat deri te lufta, për juve, për familjen e juj?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Për familjen tonë a? Hogoshti njifet një fshat me shumë njerëz patriotë, një ndër ta është edhe Isa Kastrati, që është, po, i Hogoshtit, me njerëz shumë të ngritur intelektualisht. Unë kom pa që aty femna nuk është denigru tej mase domethonë. Nëse donë ti me punu, ke pasë hapsirë me u shkollu, me punu edhe krejt. Mirëpo, në ambientin ku unë jom martu nuk ka pasë shumë t'shkollum. Burrin e kom inzhinjer, magjistër i gjeologjisë. Jemi dashuru në Prishtinë edhe jemi martu. Mirëpo, njerëzit me t'cilët kemi me jetu nuk kanë qenë në një nivel ku me ditë se sa.

Dhe fillumë me menu une qysh m'i rritë fmijën tash... po m'lindë... se krye ni vjete, mas ni vjeti m'ka

lindë Urata. Dhe qysh me menu, qysh m'i ja dalë, qysh me eduku atë fmi? Unë isha msu me ni edukatë krejt tjetër. I kom gjetë do n'kule, që s'mujsha me marrë me men ku jonë t'u jetu kta njerz.... Kështu që, fillunë të, me bisedu me aty, me atë rrethin, me atë komunitetin aty afër. Edhe fillunë njerzit m'u vetëdijsu, me vesh funa, besa ja nisën edhe miniqja me veshën. Po m'dukët se u, mbrrijtën në ni nivel t'largë ma shpejtë se që duhet, se unë menoja që çdo sen hap pas hapi është ma e sigurtë edhe ma e mirë, *step by step*.

Unë dhjetë vite kom nejt pa punë. Pas përfundimit të studimeve kom magjistru Menaxhment Edukimit me notën mesatare nantë. Mas dhjetë vjete pranona n'shköllën e Hogoshtit, n'shköllën "Skenderbeu", si profesoreshë e gjuhës shqipe. Jam munu me dhonë kontributin tim n'mënyra të ndryshme. Dhe me spjegime... se edhe ora mësimore kur mahet nëse nuk e bon atraktive edhe nxansit s'i jep përshtypje me t'ndëgju, por kur e motivon ata atëherë është pak ma ndryshe.

Nimdhjetë vite përvojë pune në arsim, unë asniherë n'jetën time nuk kom pasë problem me asni nxanës dhe asni nxanës n'jetën time jashtë derës, orës msimore, nuk e kom qitë, dhe nuk e preferoj. Asniherë n'jetën time nuk kom ditë ta fyej asni nxanës, as fmitë e mi nuk i fyj, se është gjëja ma, ma e ultë që unë menoja që ti ni t'ri me ofendu me fjalë fyse, e ku ta di une.... Dhe pas ksaj, pas nimdhetë vitesh, propozohet të jem drejtoreshë e shkoll... çerdhës "Filizat" në Kamenicë, ku edhe tash punoj.

Tani viti, para tri viteve, domethonë p'i bjen viti 2015, 2014, unë zgjidhna kryesuse e Grupit Joformal të Grave të Kamenicës. Buxheti ishte dikun... buxhet kishim t'mjaftushëm me përkrahjen e Kryetarit. Komuna dhe Grupi Joformal i Grave fiton ni fond prej 20 mijë euro. Në atë fondin e 20 mijë eurove është dashtë t'dihet mirë se kah dhe si duhet t'punohet. Unë vendosa që, me bashkëpunëtoret e mija, që këtë fond, ni pjesë t'fondit të shkoj për shkollimin joformal të grave për arsye ekonomike dhe për arsye të ndryshme që nuk kanë mund ta vazhdojnë shkollimin e mesëm. Dhe kështu që kjo eci jashtëzakonisht mirë. Kemi çu dikun 24 femna në shkollimin joformal, krytën vitin e katërt të shkollës, shkollës, profesioneve të ndryshme, ekonomi, e ku ta di unë.

Fillum prapë me përkrahë po këtë iniciativë me katër burra edhe 20 femna. Domethonë, kanë shku dy pjesë të ktij storje që e kanë kry shkollimin e mesëm, që sot do i kena studente, që kanë vazhdu domethanë. Marrja e dijës nuk osht' veç qëtu, po osht' e llojllojshme dhe e ndryshme. Tri i kemi bo biznismene. Njena është biznismenja "Tradita", ku konsumon ushqime tradicionale. Si e ka kry shkollimin e mesëm, e ka hapë, domethonë, produktet e veta ushqimore. Tjetra, kemi rrobaqepsisë, kemi dy që kanë hapë bizniset e veta të vogla të rrobaqepsisë. Domethonë, po punohet jashtëzakonisht mirë n'këtë aspekt.

Kemi kriju edhe kursin e frizereve, "Kaci", ku kanë qenë dikun 15 veta. Pesë veta janë, janë shku pa parcitipim [participim], dhe 15 veta e kemi pasë pagesën përgjysmë, gjysmën e ka pagu Grupi i Grave edhe gjysmën e kanë pagu ato vet. Diku pesëdhjetë euro i kemi kry ne dhe pesëdhjetë euro i kanë kry ato vet. Dhe ni pjesë tjetër e kemi marrë, kemi vendosë me ju dhanë pleqve që janë pa mbikqyrje. Kemi

pasë, t'komunës të Kamenicës, kemi pasë dikun pesë pleq në Domin e Pleqve, Shtëpinë e Pleqve në Prishtinë, të komunës tonë, që ju kemi dhonë ni pako solide n'vlerën e 25 eurove, secilit nga një pako. Kanë qenë dikun 25 pleq, burrë e gru, që ju ka nda kjo, edhe pesë serb.

Erëmirë Krasniqi: Krejt kjo në kuadër të?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Grupit Joformal të Gruas.

Erëmirë Krasniqi: Dhe paralelisht jeni edhe drejtoreshë e?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Prej buxhetit..

Erëmirë Krasniqi: Drejtoreshë e çerdhës?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, po edhe drejt... po n'atë kohë nuk kom qenë drejtoreshë e çerdhës, n'at' kohë kom qenë anëtare e Kuvendit Komunal. Domethanë, tash i bjen, '14, 2014, tani vij drejtoreshë e çerdhës.

Edhe n'qatë kohë kemi nda për nanat me kancer të gjirit; kemi nda për fam... fmijtë me aftësi të kufizuar, jetim. Kemi nda Shoqatës [për Personat] me Aftësi të Kufizume, ju kemi dhonë edhe pesë qind euro ni shëtitje nëpër Kosovë; kemi nda... nuk po m'kujtohen krejt; me smundje t'rana që janë, kemi pasë edhe fmi me smundje t'rana, t'palëvizshëm, kemi nda mjete edhe për ata fmijë; kemi parcitip [participuar] edhe për këtë, mobile që është...

Donjeta Berisha: Mamografinë? Mamografinë?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: ...për mamografinë, kemi dhanë dikun dy mijë euro. Ka qenë në Kamenicë, n'nivel Grupit Joformal të Grave deputete. Edhe kështu është...

Erëmirë Krasniqi: Luftën qysh e keni kalu në atë rajon? Ka qenë ma i qetë, a po?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Po, ka qenë rajoni ma i qetë. Luftën s'kom pasë rast, s'kom pasë shancë me shku n'luftë. Kom qenë n'mujin e tetë shtatëzanë, me Atdheun. Osht' shumë interesant që nuk u ndi lufta atje shumë. Ditën e Bajramit kanë t'hollu edhe bakllava, derisa hynën nëpër shpija, e panë se çka osht'. Une i kom pasë edhe dy pleq, smutë. Njoni prej, vjerrën e kom pasë epileptike edhe vjehrrin me trombozë, vjehrrin. Kur ka hy ofanziva, mrena, Urata ka qenë e vogël edhe Doruntina shumë e vogël... bile burri po m'thotë, "A po ki frikë?" Thashë, "Jo, aspak. Ni vdekje e kem. Si sot, si nesër."

Mirëpo, e vetmja gja që mu m'brejke pse me vdekë pa e myt najnjo! Me hi n'derë t'shpiisë... po për besë, po t'hin n'shpi me t'masakru edhe me lëshu me dalë... pyf, qikjo m'ka bre shumë. Po...

Erëmirë Krasniqi: Çka ju bonën?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Na qitën jashtë, domethonë prej... ishim mrena une, burri dy fmija, vajzat. Mirëpo, pleqtë ishin t'palëvizshëm. Edhe po pysin n'gjuhën serbo-kroate, "Kush jonë kta?" Burri tha, "Kta jonë prindtë e mi." Ajo që ka hy nëpër shpija te na ka qenë ushtria rregullt. Ata nuk kanë ba shumë dame, sa kanë bo kur kanë ardhë të Arkanit. Jonë djegë dikun katër shpija. Kanë myt dy njerz aty, edhe i kanë shetitë, edhe i kanë çu, paramenoje krejt me ni fshat tjetër, në Karaçevë... se di a e din ku osht' Karaçeva? Edhe pastaj na lajmërojnë t'nesrit që filan njeri osht' i vdekun në Karaçevë. Tanë natën e majnë në xhaminë e Karaçevës dhe t'nesërmin n'mëngjes e transferojnë në Hogosht.

Lufta nuk osht' asniherë e mirëseardhun. Asniherë nuk osht' e mirëseardhun kur gjanat zgjidhen me qetësi edhe n'mënyrën e duhur, por shqiptari okupatorin nuk e duron.

Erëmirë Krasniqi: A keni diçka me shtu për fund? A ka diçka që ka mbet pa u ndëgju?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Për fund çka kisha me shtu? Kisha me shtu që prindtë edhe nanat t'mirren ma shumë me fmitë e tyre, se shumë pak po mirren. Mos të thom hiç. Edukata e fëmive nuk osht' n'nivelin e duhur. Sidomos unë i shoh shumë nana, "Valla une po shkoj po punoj veç që s'po m'rrihet n'shpi." Pse lenë fmijën e mirret me gjana t'kqija, lloj lloj senesh, une nuk muj, nuk muj m'u pajtu. Edhe une jom një nanë që punoj. Punoj tetë orë.

Por, nëse osht' nevoja për fmiun tem ja kushtoj deri në ora gjashtë t'mëngjesit, edhe asniherë, asniherë nuk thom se jom e lodhur. Ose jom e lodhur, nuk po mundem, kom pasë punë shumë... edhe punët menaxheriale, e din ti vet çka jonë, sa jonë, sa ki presion, sa.... Mirëpo, për fminë gjithmonë jom *online* [e gatshme]. Kur kanë nevojë ata për mu, se fmitë gjithmonë kanë nevojë për prind.... Unë me vite t'tana me fmi, me vajzat e mija kom nejt deri n'gjashtë mëngjesit. Çdo problem, çdo gja e kemi shtjellu s'bashku. Edhe falë ktyne gjanave, komunikimi, sot jonë ku jonë.

Erëmirë Krasniqi: P'e mbyllim?

Ibadete Bunjaku – Ahmetaj: Falemnderit shumë prej juve që na dhatë rastin me shkëmby mendimet e tona në të kaluarën. Ndoshta s'kemi qenë qysh o dashtë, kërkojmë falje, po megjithatë falemnderit.

Erëmirë Krasniqi: Falemnderit!